

VENDIM
Nr. 847, datë 7.12.2016

**PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E KULTURËS (QENDRA
NDËRKOMBËTARE E KULTURËS “ARBNORI”) TE BASHKIA TIRANË, TË PRONËS
ME NUMËR PASURIE 1/53, TË NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE 8160, ME
SIPËRFAQE TRUALLI DHE NDËRTESE 4294 m², DHE PËR NJË NDRYSHIM NË
VENDIMIN NR. 286, DATË 8.8.1991, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN
E QENDRËS NDËRKOMBËTARE
TË KULTURËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001,

“Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, shkronja “d”, 5, 8, 17 e 18, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, të ministrit të Kulturës dhe të ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, nga Ministria e Kulturës (Qendra Ndërkombëtare e Kulturës “Arbnori”) te Bashkia Tiranë, të pronës me numër pasurie 1/53, të ndodhur në zonën kadastrale 8160, me sipërfaqe truall dhe ndërtesë 4294 (katër mijë e dyqind e nëntëdhjetë e katër) m², sipas planimetrisë bashkëlidhur, për t’u përdorur si qendër shumëfunksionale për organizimin e eventeve sociale, promovimin e artit, të kulturës dhe të teknologjisë.

2. Pika 2 e vendimit nr. 286, datë 8.8.1991, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Qendrës Ndërkombëtare të Kulturës”, shfuqizohet.

3. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme, ministri i Kulturës, ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, kryetari i Bashkisë Tiranë dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Permisión: D.P.J.A.I., BASHKIA E TIRANËS
Nr. Prot. 33907/2, Datë: 10/11/2016

